

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje mishi dhe nenprodukteve te tij

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

2. Kodi CPV : Produkte shtazore, mish dhe produkte te mishit 15100000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,800,000 (njemilion e teteqind mije) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2021, 2022 dhe 2023, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e parshikuar e kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili

anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 43 pka 2/b të VKM nr.285 datë 19.05.2021 ku citohet ” sa vlera e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021 dhe 2022 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së

njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetimi i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1-Për produktet e mishit (mish vici, mish pule, fileto pule, kremvice etj.) të paraqitet certifikatë UNI 10854 - Standard i Sistemeve të Vetëkontrollit Higjenik bazuar në metodën HACCP) / ekuivalente dhe e vlefshme dhe ISO 22000 (Standard për Sistemet e Menaxhimit për Sigurinë e Ushqimit) / ekuivalente dhe e vlefshme. Në rastin e ofertave të paraqitura nga operatorë ekonomikë që nuk janë prodhues duhet të paraqitet kontrata e bashkëpunimit me prodhuesin/distributorin.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 pika 1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 44 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.3 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë 1 (një) automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer).

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, leja e transportit të mallrave (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton), akt miratimi higjeno–sanitar dhe foto perkatëse.

Për mjetet me rrota, që shënohen në regjistra publike, që merren me qira, të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi dhe leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, leja e transportit të mallrave (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton), akt miratimi higjeno–sanitar dhe foto perkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Automjeti nevojitet për transportin brenda normave higjieno-sanitare të lejuara të produkteve ushqimore objekt i kontratës

2.3.4 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për përpunimin ose tregtimin ose magazinimin e produkteve objekt prokurimi. Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë. Për të vërtetuar këtë të paraqitet certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe foto të ambientit të brendshëm të përpunimit ose tregtimit ose magazinimit, të produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit, objekt prokurimi.

Në rastin kur ambjenti merret me qira/huapërdorje duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qira/huapërdorje; certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe foto të ambientit të brendshëm të përpunimit ose tregtimit ose magazinimit, të produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit, objekt prokurimi

Argumentimi: Kjo kërkesë është bazuar në natyrën e kontratës së furnizimit, i cili është furnizim i përditshëm dhe për një afat 12.- muor duke krijuar kështu nevojën për një ambient për magazinimin e produkteve. Kjo kërkesë është e domosdoshme dhe krijon kushte të favorshme dhe praktike për një furnizim sa më të shpejt në kohë dhe me kosto më të ulët për operatorin ekonomik.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

NJESIA E PROKURIMIT